



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. Nr. Prot.
Org. Jedinica Broj Prot.
Org Unit Prot. No. 01 01-366

Nr. i faqeve Data:
Br. stranica Datum:
No. pages -07- Date: 27/01/2020

Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

REFERENCË:	MSH/DSHB/MGJ/ 14 /01 /2020				
PËR/ZA/TO:	Të gjithë drejtorët e burgjeve të Kosovës Të gjithë Mjekët Përgjegjës të NjSh të Burgjeve				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
CC:	Z. Uran ISMAILI, Ministër i Shëndetësisë Z. Abelard TAHIRI, Ministër i Drejtësisë Z. Nehat THAQLI, Drejtor i ShKK, MD Dr. Naim BARDIQLI, Sekretar i Përgjithshëm i MSh Prof. Dr. Naser RAMADANI, Drejtor i IKSHPK				
NGA/OD/FROM:	Prof. Asoc. Dr. Milazim H. GJOCAJ, MD, MSc, PhD. Drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, MSh;				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkese për ndërmarrje të masave kundër epidemike për parandalimin e përhapjes së Novel Coronavirus në burgje				
Nr. i zyrës:	107	Lokacioni:	MSh	Data:	27.01.2020
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI / KRAJINI ROK / DEADLINE					Menjëherë

Të nderuar,

Bazuar në gjendjen e përgjithshëm globale, Rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) lidhur me paraqitjen e Epidemisë së Novel Coronavirus, në funksion të parandalimit të kësaj epidemie, e veçmas në burgje duke qenë se janë vend i përshtatshëm për përhapjen e sëmundjeve, kërkojë nga ju që:

1. Të respektohen Rekomandimet e IKShPK-së për institucionet shëndetësore në vend;
2. Të respektohen Rekomandimet specifike të kësaj shkrese për Burgjet.
3. Të përfillen dhe zbatohen Raportimet e rasteve dhe mungesës së kushteve higjienike e sanitare në institucione.

Duke pasur parasysh rëndësinë e veçante që kanë burgjet në këtë aspekt, rekomandoj që të merren këto masa kundër epidemike në burgje:

a. masat e përgjithshme kolektive:

1. Të mirëmbahet higjiena e shtuar e hapësirave individuale dhe kolektive të të gjitha burgjeve,
2. Të bëhet dezinfektimi i vazhdueshëm me preparate të klorit i të gjitha hapësirave në baza të rregullta ditore, sipas nevojës edhe me shpesh gjatë ditës,
3. Të bëhet ajrosja e vazhdueshme e hapësirave kolektive dhe individuale,
4. Të mbikëqyret përgatitja dhe servimi i ushqimit sipas protokolleve të kushteve higjienike sanitare me kujdes të veçantë.

b. masat individuale:

1. Të ketë mbikëqyrje të vazhdueshme të higjienës personale të tërë personelit dhe të burgosurve në të gjitha burgjet,
2. Të bëhet mbikëqyrja e mbajtjes së higjienës së hapësirave dhe gjëseneve personale të të gjithë personelit dhe të burgosurve në burgje,
3. Të bëhet verifikimi i vazhdueshëm i kualitetit të kontrollimeve sanitare dhe i posedimit të afatit të librezave sanitare për stafin e kuzhinave, stafin mjekësor dhe të tjerë të paraparë më parë, sipas kalendarit të caktuar (Shkurt – Shtator për stafin dhe të tjerët që punojnë në kuzhinë, dhe shkurt për stafin mjekësorë).

c. masat e veçanta:

1. Ndalimi, kufizimi i hyrjes së vizitorëve dhe personave të tjerë, personelit apo kontraktorëve me shenja të gripit apo të ndonjë infeksioni të ngjashëm në të gjitha burgjet deri në pushimin e kësaj mase në funksion të parandalimit të sjelljes së infeksionit brenda në burgje,

2. Dezinfektimin e vazhdueshëm, të pa ndërprerë të të gjitha hapësirave të vizitave në të gjitha burgjet.
3. Ajrosjen e vazhdueshme të këtyre hapësirave gjatë tërë kohës.

d. DDD e përgjithshme e të gjitha hapësirave të jashtme dhe të brendshme të burgjeve

1. Te organizohet DDD e plotë e të gjitha burgjeve ;
2. Organizimin e kësaj fushate të DDD do ta bëjë DShB dhe kompania qe do të ketë kontratë;
3. Të zhvillohen procedurat e urdhërimit për kryerje të të shërbimit nga njësitë përkatëse të MSh-së edhe nëse mungojnë mjete në këtë fazë si rezultat i vështirësive në alokim të buxhetit duke ditur se kjo masë është e planifikuar edhe me kontratë edhe me buxhet;

Bartës të këtyre aktiviteteve:

1. Drejtorët e Burgjeve dhe Udhëheqësit Shëndetësor të Burgjeve;
2. Kryekuzhinieret e burgjeve;
3. Përgjegjësit e higjienës dhe materialit higjienik të burgjeve;
4. Stafit tjetër i përcaktuar nga Drejtori i Burgut;
5. Kompania kontraktuese për DDD;

Mbikëqyrjen e këtyre aktiviteteve do ta bëjë:

1. Drejtoria Qendrore e Burgjeve;
2. Departamentin Shëndetësor të Burgjeve;
3. Institucionet e tjera relevante nëse paraqitet një nevojë e tillë;
4. IKShPK-në dhe ISHP –të regjionale.

Mjeket përgjegjës të burgjeve, obligohen që në baza të rregullta mujore të raportojnë lidhur me aplikimin e këtyre masave, në rast nevojë edhe më shpesh dhe të zbatojnë këtë rekomandim dhe atë të IKShPK-së të bashkëlidhur kësaj shkrese.

Drejtoria e Burgjeve po ashtu obligohet që të furnizoj të gjitha burgjet me materialin e nevojshme për ndërmarrjen e këtyre masave.

Me respekt!